



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE  
DREJTORIA E ANALIZËS LIGJORE DHE HARTIMIT TË AKTEVE

Nr. 1238/ prot.

Tiranë, më 16.05.2022

URDHËR

Nr. 43, datë 16.05.2022

"PËR

DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 14, DATË 27.01.2021 "PËR MËNYRËN  
E RAPORTIMIT DHE MONITORIMIT TË PLANIT STRATEGJIK DHE  
PLANIT TË VEPRIMIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË  
DREJTËSISË"

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, nenit 204, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe në përputhje me kreun V të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2020-2022 për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratuar me urdhrin nr. 106, datë 01.12.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e planit strategjik dhe planit të veprimit, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2021", si dhe rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të performancës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2021 me nr. 3172/2, datë 12.07.2021.

URDHËROJ:

1. Kudo në përmbajtje të urdhrin, nr. 14, datë 27.01.2021, termi "tremujor" të zëvendësohet me termin "katërmujor", për qëllime të harmonizimit të afatit të raportimit të strategjisë së institucionit me periudhën e raportimit pranë ministrisë përgjegjëse për financat në kuadër të raportimit dhe monitorimit të buxhetit.
2. Në pikën 3, germa "a", të urdhrin nr. 14, datë 27.01.2021, ndryshon me këtë përmbajtje:  
"a. U kërkon titullarëve të strukturave përgjegjëse të përcaktuar në planin e veprimit ose personave të caktuar prej tyre, përcjelljen e informacioneve për njësinë e caktuar, brenda datës 5 të çdo katërmujori pasardhës në përputhje me masat/aktivitetet e parashikuara."
3. Në pikën 4, të urdhrin nr. 14, datë 27.01.2021, bëhen këto ndryshime:  
"Çdo strukturë ose person i caktuar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pas marrjes së kërkesës për informacion nga Sektori i Raportimit dhe

Përfaqësimit, raporton pranë këtij Sektorit mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet/masë sipas fushës së veprimtarisë së secilës njësi organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda datës 20 të katërmujorit pasardhës. Mënyra e raportimit bëhet sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.”.

4. Në pikën 5, të urdhrit nr. 14, datë 27.01.2021, bëhen këto ndryshime:
  - a. “Sektori i Raportimit dhe Përfaqësimit, brenda datës 28 të çdo katërmujori pasardhës, harton raportin mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet/masë, të shprehur në përqindje mbi nivelin e përmbushjes së secilit aktivitet/masë, në funksion të përmbushjes së objektivave specifik (të shprehur në %) dhe objektivit strategjik (të shprehur në %) dhe e dorëzon atë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pas vlerësimit të Komisionit të Monitorimit dhe Raportimit të Strategjisë;
  - b. Niveli i zbatimit të secilit aktivitet/masë në përqindje (X), llogaritet duke pjesëtuar totalin e përqindjes (100%) me numrin e nënaktiviteteve të zhvilluar për atë aktivitet/masë (Y) ( $X = 100\% / Y$ );
  - c. Arritjet progresive të aktiviteteve sipas katërmujorit përkatës, llogariten në përqindje duke treguar rezultatin për çdo objektivi;
  - d. Raporti i monitorimit katërmujor përmban:
    - i. nivelin e arritjes së çdo objektivi specifik brenda periudhës së caktuar duke llogaritur numrin e nën aktiviteteve të zhvilluara në funksion të çdo aktiviteti;
    - ii. përlllogaritjen në përqindje të kostos së buxhetit për secilin aktivitet;
    - iii. ecurinë progresive të çdo objektivi strategjik (objektiv specifik , aktivitete) nga data e miratimit të planit strategjik deri në datën e raportimit.
  - e. Raportet katërmujore të monitorimit, i përcillen Komisionit të Monitorimit dhe Raportimit të Strategjisë, i cili koordinon dhe unifikon informacionin mbi treguesit efektivë të monitoruar.”, brenda 5 ditëve nga marrja e raportit katërmujor .
5. Ngarkohen të gjitha njësitë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me zbatimin e këtij urdhri.
6. Ngarkohet Drejtoria e Analizës Ligjore dhe Hartimit të Akteve për të reflektuar shtesat e miratuara me këtë urdhër në një tekst të vetëm integral që pasqyron variantin në fuqi të urdhrit nr. 14, datë 27.01.2021 “Për mënyrën e raportimit dhe monitorimit të planit strategjik dhe planit të veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022” dhe përcjelljen e variantit integral pas miratimit të këtij urdhri, Drejtorisë e Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

7. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin e këtij urdhri dhe publikimin e planit të veprimit të rishikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

**Artur Metani**



Aneksi nr. 1 “Modeli i raportimit dhe monitorimit të planit të veprimit 2020-2022”

Raportim për Planin e Veprimit 2020-2022

Nr. Aktivitetit	Detajimi i aktivitetit	Struktura raportuese/ përgjegjëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Mënyra e matjes/treguesi I realizimit të aktivitetit	Ecuria e zbatimit të aktivitetit për periudhën Dhjetor 2020 - Gusht 2021	niveli i realizimit të aktiviteteve në %	arritja progresive sipas afateve të maturimit në %	realizimi në % sipas buxhetit